

Gjykata Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë/divizioni civil, civile, me gjyqtarin Haki Kryeziu , sipas padisë së paditësit M. H. B. nga B., Komuna e Malishevës, ndaj të paditurit I. H. H. nga B., lidhur me vërtetimin e pronësisë në bazë të shitblerjes , jashtë seancës gjyqësore me datën 04.01.2019 muar

A K T G J Y K I M PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES

- I. Aprovohet** kërkesëpadija e paditësit M. H. B. nga B. si e bazuar.
- II.** Vërtetohet së paditësi M. H. B. nga B., Komuna e M. , në bazë të kontratës së shitblerjes është pronar i paluajtshmerisë i ngastrës kadastrale P-..., ZK B., në vendin e quajtur “Ara e Gat-Bare”, në sipërfaqe prej ha, sipas çertifikatës së pronës, lëshuar nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronësi në Malishevë.
- III.** Detyrohet i padituri I. H. H. nga B. t’ia njeh këtë të drejtë dhe t’ia lejoj paditësin në regjistrimin e kësaj paluajtshmerie në emër të paditësit në librat kadastral pranë Drejtorisë për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronësi në Malishevë, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.
- IV.** Detyrohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronësi në Malishevë që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi , paluajtshmerinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi t’ia regjistroj në librat kadastral në emër të paditësit M. H. B. nga B..
- V.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me datën 13.12.2018, pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë ka parashtruar padi ndaj të paditurit I. H. H. nga B. , lidhur me vërtetimin e pronësisë në bazë të shitblerjes të ngastrës kadastrale P-..., ZK B., në vendin e quajtur “Ara e Gat-Bare”, në sipërfaqe prej ... ha, sipas çertifikatës së pronës, lëshuar nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronësi në Malishevë.

Gjykata të paditurin e ka njoftuar me aktvendim mbi dhënjen e përgjigjes në padi , duke ia bashkangjitur aktvendimit padinë me provat e parashtruara.

I padituri pas marrjes së aktvendimit ka parashtruar përgjigje në padi, duke e pranuar kërkesëpadinë e paditësit dhe duke ia njohur të drejtën paditësit në paluajtshmerinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Paditësi në padi ka theksuar se nga i padituri ka blerë paluajtshmerinë dhe ate ngastrën kadastrale P-..., ZK B., në vendin e quajtur “Ara e Gat-Bare”, në sipërfaqe prej ... ha, sipas çertifikatës së pronës dhe per këtë paluajtshmeri e ka permbushur në tërësi detyrimin ndaj të paditurit dhe tani është në posedim dhe shfrytëzim të kësaj paluajtshmerie, e cila në fletën poseduese është e regjistruar në emër të paditurit.

Kjo vërtetohet edhe në bazë të përgjigjes në padi të dhënë nga i padituri me dt. 13.12.2018 ku ka theksuar se e pranon se paditësit ia ka shitur paluajtshmerinë e sipërshtënuar, duke mos e kontestuar kërkesëpadinë e paditësit , me arsyetimin se paditësi ndaj të paditurit i ka përmbushur të gjitha detyrimet dhe që nga atëherë është në posedim të kësaj paluajtshmerie.

Gjykata marrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor të çështjes e mbështeti në nenin 152 të LPK-së bazuar në faktin së poqesë i padituri me anë të përgjigjes në padi i pohon faktet vendimtare ,përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë , gjykata mundët pa caktuar seancë gjyqësore ,të jep aktgjykim pa shqyrtim kryesor të çështjes nëse nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor të çështjes. Edhe dispozita e nenit 398 e LPK-së parashih shprehimisht së gjykata mund të jap aktgjykim pa shqyrtim kryesor të çështjes ,nëse pas marrjes së përgjigjes në padi konstaton së në mes palëve nuk ekziston kontest lidhur me faktet relevante. Sipas përgjigjes në padi, në mes palëve procedurale nuk ekziston kontest lidhur me ngastrat kadastrale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, përderisa i padituri e ka pranuar kërkesëpadinë e paditësit ,lidhur me shitblerjen e kësaj paluajtshmerie.

Meqenëse në mes palëve nuk ekziston kontest lidhur me faktet relevante, fakte që u vërtetuan edhe nga gjykata me shqyrtimin e provave që gjenden në shkresa të lëndës, gjykata bazuar në dispozitat e nenit 152 dhe 398 të LPK-së vendosi t`a aprovoj kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe për këtë vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me sa u tha më lartë,u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Gjykata Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë/Divizioni civil/
C.nr.410//18 me datën 04.01.2019**

Gjyqtari
Haki kryeziu

Udhëzim juridik: Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës. Ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate.